



**UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI”VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

Temë diplome për

Master Shkencor në Shkenca Infermierore

Viti 2020

**TEMA: “VETËMENAXHIMI I DIABETITI TIPI 2, IMPLIKIME
INFERMIERORE”.**

DIPLOMANTI:

Vjolanda ISLAMAJ

UDHËHEQËS SHKENCOR

Dr. Fatjona KAMBERI

VLORË, SHTATOR 2020

DEKLARATË

Deklaroj se teza e titulluar “**VETËMENAXHIMI I DIABETIT TIPI 2, IMPLIKIME INFERMIERORE**” është puna ime origjinale dhe të gjitha të ardhurat e përdorura për realizimin e kësaj teze janë kontributi im personal.

FIRMA:

DATE: ___/___/2020

Vjolanda Islamaj

Përmbajtje

1. Shkurtime	3
2. Lista e tabelave	4
3. Lista e grafikëve	7
4. Abstrakt	8
5. Pjesa teorike	9
5.1 Hyrje.....	9
5.2 Çfarë është Diabeti Melitus tip 2.....	10
5.3 Cilët janë më të riskuar për të zhvilluar Diabetin tip 2.....	12
5.4 Epidemiologjia e Diabetit tipi 2.....	13
5.5 Komplikacionet e Diabetit Melitus tipi 2.....	15
5.6 Trajtimi i Diabetit Melitus tipi 2.....	19
5.7 Roli infermieror në vetëdukimin e pacientit.....	25
5.8 Vetmenaxhimi i Diabetit nga pacienti.....	27
6. Pjesa studimore	29
6.1 Qëllimi dhe Objektivat.....	29
6.2 Metodologjia.....	29
6.3 Instrumenti i matjes së të dhënave.....	30
6.4 Analiza statistikore.....	30
6.5 Konsiderata etike.....	30
6.6 Përkufizime konceptuale.....	31
7. Rezultatet	32
8. Diskutimi	56
9. Konkluzione	58
10. Rekomandime	59
11. Referenca	60
12 Aneks	67

1. SHKURTIME

HBA1c	-Hemoglobina e glukozuar
IGT	-Tolerancë e dëmtuar e glukozës
DM 2	-Diabet Melitus tipi 2
DM	-Diabet Melitus
ËESDR	- Studimi Epidemiologjik i Ëisconsin i Retinopatisë Diabetike
NHANES III	-Sondazhi i Tretë Kombëtar i Shëndetit dhe Ekzaminimit të Ushqimit
SAS	- Sindromi i Apnesë së Gjumit
RDI	- Indeks i shqetesimit në frymëmarrje
AHI	- Apne/hipopne
SC	- Subcutane
OHA	- Antihyperglicemikë të administruar nga goja
DPP4	- Dipeptidil-peptidaza 4
SGLT2	-Frenuesit e transportuesit të natriumit-glukozës-2
GLP-1	-Inkrertin mimetik, receptor agonist
NPH	-Insulina izofan
MD	-Dieta mesdhetare
MNT	-Terapia mjekësore ushqimore
PA	-Aktivitet fizik
RDN	-Dietologët e regjistruar dietolog
CVD	- Sëmundjet kardiovaskulare
DSN	- Infermierët specialist të diabetit
QOL	- Cilësia e jetës
BMI	- Indeksi i masës trupore
TV	- Televizion

2. LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Karakteristika të moshës.....	32
Tabela 2. Karakteristika të gjinisë.....	32
Tabela 3. Karakteristika të punësimit.....	32
Tabela 4. Mjekimi i përdorur për diabetin.....	33
Tabela 5. Kohëzgjatja e mjekimit të përdorur.....	33
Tabela 6. Prania e sëmundjeve shoqëruese.....	33
Tabela 7. Respektimi i mjekimit.....	34
Tabela 8. A ka ndihmuar kutia e medikamenteve si kujtesë për mjekimet.....	34
Tabela 9. Sa shpesh e monitoroni glukozën.....	35
Tabela 10. Sa e kani HBA1c.....	35
Tabela 11. Reduktimi i sheqerit në dietën ushqimore.....	35
Tabela 12. Përdorimi i zëvendësuesve në dietë.....	36
Tabela 13. Përdorimi i sjelljeve devijuese nga dieta.....	36
Tabela 14. Përdorimi i pijeve me përmbajtje sheqeri.....	36
Tabela 15. Përdorimi i pijeve dietike.....	37
Tabela 16. Reduktimi i ushqimeve me përmbajtje amidoni.....	37
Tabela 17. Rritje e konsumit të frutave dhe perimeve.....	37
Tabela 18. Përdorimi i ushqimeve pa përmbajtje niseshteje.....	38
Tabela 19. Përdorimi i frutave si një vakt i lehtë.....	38
Tabela 20. Përgatitja e ushqimeve pa yndyrë.....	38
Tabela 21. Reduktimi i yndyrës në dietë.....	39
Tabela 22. A gatvani mish me përmbajtje të ulët yndyre.....	39

Tabela 23. A e keni reduktuar alkoolin.....	40
Tabela 24. A e keni reduktuar kripën.....	40
Tabela 25. A e kontrolloni sasinë e kalorive që merrni.....	40
Tabela 26. A përdorni strategji kur hani jashtë.....	41
Tabela 27. Përdorimi i një orari në ushqyerje.....	41
Tabela 28. Përdorimi i një diete të përshtatur për diabetin.....	41
Tabela 29. Paaftësit fizike.....	42
Tabela 30. Kryerja e aktivitetit fizik.....	42
Tabela 31. Informacioni që keni mbi sëmundjen e diabetit*gjinia.....	43
Tabela 32. Çfarë duhet të hani*gjinia.....	43
Tabela 33. Si duhet të testohet glukoza.....	43
Tabela 34. Ushtrimet që duhen kryer.....	44
Tabela 35. Informacion jo i dobishëm.....	44
Tabela 36. Informacion rreth sëmundjes.....	44
Tabela 37. Mbështetje sociale.....	45
Tabela 38. Përditshmëria e mbështetjes sociale.....	45
Tabela 39. A përdorni dietë të përshtatshme për diabetin*gjinia.....	46
Tabela 40. A e keni reduktuar sheqerin në dietë*gjinia.....	46
Tabela 41. A përdorni zëvendësues të sheqerit në dietë*gjinia.....	46
Tabela 42. A përdorni sjellje që ju devijojnë nga dieta*gjinia.....	47
Tabela 43. A përdorni pije me përmbajtje sheqeri*gjinia.....	47
Tabela 44. Reduktimi i ushqimeve me përmbajtje niseshteje*gjinia.....	47
Tabela 45. A e keni rritur sasinë e frutave dhe perimeve*gjinia.....	48
Tabela 46. A përdorni fruta si një vakt të lehtë*gjinia.....	48

Tabela 47. I gatuani ushqimet pa yndyrë*gjinia.....	49
Tabela 48. A gatuani mish me përmbajtje të ulët yndyre*gjinia.....	49
Tabela 49. A e keni reduktuar alkoolin*gjinia.....	49
Tabela 50. A e keni reduktuar kripën*gjinia.....	50
Tabela 51. A e kontrolloni sasinë e kalorive *gjinia.....	50
Tabela 52. Përdorni strategji kur hani jashtë*gjinia.....	50
Tabela 53. A keni orar në ushqyerjen tuaj*gjinia.....	51
Tabela 54. Kryerja e aktivitetit fizik*gjinia.....	51
Tabela 55. Ushtrimet që kryeni *gjinia.....	52
Tabela 56. Paaftësit*gjinia.....	52
Tabela 57. Informacioni mbi sëmundjen*shkollimi.....	52
Tabela 58. Zëvendësimi i sheqerit*shkollimi.....	53

3. LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Prevalenca e DM2 në vitin 2019, në popullatën e rritur.

4. ABSTRAKT

Abstrakt

Hyrje

Diabeti mellitus është një sëmundje endokrinologjike dhe / ose metabolike me incidencë dhe prevalencë në rritje e cila shoqërohet me rritje të sheqerit në gjak. Ndërkohë që diabeti mellitus tipi 2 (DM 2) është duke u shdërruar në një epidemi në disa shtete, në të cilat pritet që numri i njerëzve të prekur të dyfishohet dekadën tjetër për shkak të plakjes së popullsisë. Modalitetet e trajtimit përfshijnë modifikimin e mënyrës së jetesës, trajtimin e mbipeshes, agjentët hipoglicemik oral dhe sensibilizuesit e insulinës si metformina, biguanidet që zvogëlojnë rezistencën ndaj insulinës. Theksi do të vihet në njohuritë dhe mënyrat e vetmenaxhimit të sëmundjes.

Qëllimi i studimit

Vlerësimi i nivelit të vetmenaxhimit të diabetit tipi 2 te pacientët që trajtohen nga mjeku i familjes në qendra shëndetësore në qytetin e Vlorës si dhe identifikimi i faktorëve të mundshëm dhe pengesave që ndikojnë në vetmenaxhimin dhe vetëkujdesin e sëmundjes.

Metodologjia

Studimi do të jetë i tipit transversal. Të dhënat e studimit u mblodhën në periudhën Qershor – Korrik 2020 nëpërmjet një pyetësi standart anonim të bazuar në literaturë. Shëpërndarja e pyetësorit u krye nëpërmjet platformës google form. Identifikimi i personave me Diabet tipi 2 u krye nga regjistrat e mjekut të familjes. Pyetësi përbëhej nga 5 seksione me pyetje për vetmenaxhimin e diabetit si dhe një seksion për të dhënat socio--demografike. Në studim u përfshin 134 pacientë të grupmoshës 18-85 vjeç. Vlera të $p < 0.05$ u konsideruan të rëndësishme nga ana statistikore.

Rezultatet

Mosha mesatare pacientëve ishte 42.7 vjeç dhe $SD \pm 15,5$. 69.40% e pjesëmarrësve ishin femra dhe 30.60% meshkuj. Lidhje sinjifikante statistikore u gjet midis të dhënave socio-demografike, (gjinisë) dhe variablit "dieta ushqimore", $p < 0.001$, si edhe midis gjinisë dhe "aktivitetit fizik" $p < 0.001$ Gjithashtu u gjetën lidhje të rëndësishme midis njohurive për vetmenaxhim të sëmundjes edhe arsimimit $p < 0.05$.

Konkluzionet

Studimi evidentoi mungesën e pranisë së informacioneve në mënyrë të barabartë për popullatën e përfshirë në studim për vetmenaxhimin e sëmundjes. Femrat ishin ato që kryenin vetmenaxhim më të mirë në krahasim me meshkujt në lidhje me dietën ushqimore dhe aktivitetin fizik. Studimi evidentoi edhe rëndësinë e shkollimit në njohuritë për vetmenaxhim të sëmundjes, kështu personat me arsim të lartë kishin njohuri më të mira për vetmenaxhim të sëmundjes. Fokus i vecantë duhet dhënë drejt krijimit të programeve edukative sipas target grupeve nga profesionistët e shëndetit me qëllim rritjen e nivelit të vetmenaxhimit të diabetit tipi 2 dhe reduktim të kostove shëndetësore të sëmundjes.

Fjalët kyçe: pacientë, diabet tipi 2, vetmenaxhim, vlerësim, modifikim etj.

5. PJESA TEORIKE

5.1. HYRJE

Diabeti mellitus është një sëmundje endokrinologjike dhe / ose metabolike me një incidencë dhe prevalencë në rritje. Nivele të larta të glukozës në gjak janë tregues të diabetit mellitus si pasojë e pamjaftueshmërisë të sekretimit të insulinës pankreatike ose veprimi të dobët të insulinës për ne indet e synuara. Diabeti mellitus rëndohet dhe shoqërohet me komplikime metabolike që më pas mund të çojnë në vdekje të parakohshme.[1]. Ashpërsia e simptomave varion nga tipi dhe kohëzgjatja e tyre. Disa nga pacientët diabetik janë asimptomatik vecanërisht ata me tipin 2 të diabetit kryesisht në vitet e para të sëmundjes, të tjerët me hiperglicemi të thjesuar kryesisht fëmijët me një mungesë të theksuar të insulinës, mund të vuajnë nga poliuria, polidipsi, polifagi rënie në peshë etj. Diabeti i pakontrolluar mund të çojë në gjendje stupori, koma, madje dhe vdekje, si pasojë e gjendjes së ketoacidozës të rrallë nga sindromi hyperosmolar jeketotik[2,4].

Sipas një studimi në Hollandë rezultoi që prevalenca më e lartë e DM është në vendet e lindjes. Kështu në banorët e Amsterdimit u gjet një risk më i lartë në popullatën turke(5.6%), marokenët (8.0%) në krahasim me popullatën vendase (3.1%). Këto rezultate janë si shkak e niveleve të ulëta socioekonomike në këto popullata. Moshë e fillimit të diabetit në këto popullata është respektivisht një ose dy dekada më shpejt se në popullatën vendase [5]. Gjithashtu në një studim të bërë në disa klinika europiane, në 1,217 meshkuj dhe 1,170 femra të moshës 25-60 vjeç me nivele të ndryshme socio ekonomike, rezultoi që personat e marrë në studim me nivel të ulët socioekonomik (arsim të ulët) kishin diabet për një kohë më të gjatë, kishin nivelet më të larta të HbA1c dhe kolesterolit më të lartë në gjak sesa grupi me personat me arsim të lartë[6].

Faktorë të tjerë rrisin rrezikun për diabetin përmendim:

- ∞ Gjenetika
- ∞ Mbipeshë
- ∞ Ushqyerje jo e mirë
- ∞ Mungesa e aktivitetit fizik
- ∞ Moshë e madhe
- ∞ Presioni i lartë i gjakut
- ∞ Etniciteti
- ∞ IGT(Tolerance e dëmtuar e glukozës)
- ∞ Historik me diabet gestacional
- ∞ Ushqyerje e dobët gjatë shtatzanisë
- ∞ Faktorë ambiental[7]

5.2. CFARË ËSHTË DIABETI MELITUS TIPI 2?

DM 2(diabeti melitus tipi) është një crregullim metabolik kronik, në të cilin prevalenca po rritet në të gjithë botën. Si rezultat DM tipi 2 është duke u shëndrruar në një epidemi në disa shtete, në të cilat pritet që numri i njerëzve të prekur të dyfishohet dekadën tjetër për shkak të plakjes së popullsisë. Duke u bërë kështu një barrë për ofruesit e kujdesit shëndetësor sidomos në vendet e varfra.[8]

Ende nuk është gjetur kurë për sëmundjen, sidoqoftë, modalitetet e trajtimit përfshijnë modifikimin e mënyrës së jetesës, trajtimin e mbipeshes, agjentët hipoglicemikë oral dhe sensibilizuesit e insulinës si metformina dhe biguanidet që zvogëlojnë rezistencën ndaj insulinës, metformina është ende medikamenti më rekomanduar i linjës së parë, veçanërisht për pacientët obez. Medikamente të tjera efektive përfshijnë jo-sulfonilurea, tiazolidinediones, frenues të alfa glukozidazës, dhe insulinë. Hulumtimet e fundit në patofiziologjinë e tipit 2 DM kanë çuar në prezantimin e ilaçeve të reja si analoge peptidesh të ngjashme me glukagonin: frenuesit dipeptidil peptidazë-IV, frenuesit e transportuesve të natriumit-glukozës 2 dhe 11 β -hidroksysteroid dehidrogjenaza 1, insulina që lëshon glukokinazën, aktivizuesit dhe agonistët e receptorit të acidit yndyror të shoqëruar me pankreatik-G-proteinë, antagonistët e receptorit të glukagonit, frenuesit metabolikë të daljes së glukozës hepatike dhe bromokriptinës me veprim të shpejt. Insulina e inhaluar është licensuar për përdorim në vitin 2006, por është tërhequr nga tregu për shkak të përkrahjes të ulët [8]. Pavarësisht zgjedhjes së agjentëve farmakologjikë, mjekët duhet të ofrojnë edhe qasjet jo-farmakologjike, të modifikimit të dietës, kontrollit të peshës dhe ushtrimeve të rregullta. Përsa u përket agjentëve farmakologjikë, këta duhet të bazohen në karakteristikat e pacientit, nivelin e kontrollit të glukozës dhe konsideratat e koston. Kombinimet e agjentëve të ndryshëm oral mund të jenë të dobishëm për kontrollin e hiperglicemisë përpara se të bëhet e nevojshme terapia me insulinë. Një qasje e kujdesit të hapur ndaj terapisë së medikamenteve mund të sigurojë qasjen më racionale, me kosto të efektshme për menaxhimin e kësaj sëmundjeje. Analizat farmako-ekonomike të provave klinike janë të nevojshme për të përcaktuar strategji me kosto efektive të trajtimit për menaxhimin e diabetit tipi 2 [9].

Simptomat. Përsa u përket simptomave në diabetin tip 2 gjendja nga të qenit plotësisht i shëndetshëm në atë të diagnostikuar me diabet, mund të kërkojë një periudhë të gjatë vitesh, pasi zhvillimi i sëmundjes është i ngadaltë.. Trupi vazhdon të prodhojë insulinë, por qelizat ngadalë humbasin aftësinë për ta përdorur atë, kështu që nivelet e glukozës do të rriten dhe trupi fillon të prodhojë më shumë insulinë për të kompensuar nivelet e larta të glicemisë në gjak. Ndryshimi mund të mos jetë menjëherë i dukshëm pasi nuk ka dhimbje që shoqërohet me këtë proces, por shenjat paralajmëruese të rritjes së glukozës në gjak do të manifestohen në të gjithë trupin.

- ∞ Sytë tuaj do të hasin vështirësi ndërsa glukozja vesh në enët e gjakut. Me ndërhyrjen e hershme kjo mund të mjekohet, por nëse lihet e patrajtuar për një kohë të gjatë, një gjendje e quajtur retinopati diabetike mund të ndodhë dhe të shkaktojë dëme të përhershme afatgjata në enët e gjakut të syve.
- ∞ Duart dhe këmbët mund të pësojnë mpirje dhe ndjesi shpimi gjilpërash nga neuropatia periferike, një problem i dhimbshëm që prek nervat në duar dhe këmbë. Glukoza e tepërt krijon një terren për infeksione të dobishme kërpudhore në mënyrë sistematike në lëkurën

tuaj, thonjtë dhe organet gjenitale. Kjo mund të bëjë të mundur që edhe plaga më e vogël do të kërkojë “përgjithmone “ për tu shëruar. [10,11].

- ∞ Etje
- ∞ Urinim i shpeshtë
- ∞ Ndjeheni shumë të uritur ose shumë të lodhur
- ∞ Humbja e peshës e menjëhershme
- ∞ Plagë që shërohen ngadalë[12]

Parandalimi. Në dekadat e kaluara, të dhënat nga studimet e prospektive observuese dhe nga gjykimet klinike i kanë dhënë rëndësi, ushqyerjes dhe modeleve dietike në parandalimin dhe menaxhimin e diabetit tip 2. Cilësia e yndyrnave dietike dhe karbohidrateve të konsumuara është më e rëndësishme sesa është sasia e këtyre makronutrientëve. Dietë e pasur me drithëra integrale, fruta, perime, bishtajore dhe arra, konsumimi i moderuar i alkoolit, dhe zvogëlimi i pijeve të ëmbëlsuara me sheqer janë tregues, që zvogëlojnë rrezikun e diabetit dhe përmirësojnë nivelin e glicemisë dhe lipideve në pacientët me diabet. Me një theks në cilësinë e përgjithshme të dietës disa modele dietike siç janë, Dieta Mesdhetare dhe dietat vegjetariene mund të përshtaten për preferencat personale në ushqim dhe në kulturën e pacientit si edhe të nevojave të përgjithshme për parandalimin dhe menaxhimin e diabetit. Megjithëse është bërë shumë përparim në zhvillimin dhe zbatimin e rekomandimeve të bazuar në prova të ushqimit në vendet e zhvilluara, përpjekjet dhe politikat e bashkërenduara në të gjithë botën janë të garantuara për të lehtësuar pabarazitë rajonale[13]. Gjithashtu duhet patur parasysh se mbipësia dhe obeziteti përbëjnë faktorë risku për DM 2, për të cilat thuhet sipas studimeve të ndryshme, se janë shkaktarët kryesor për rritjen e prevalencës të DM 2. Modifikimi i stilit të jetesës që synon të rrisë aktivitetin fizik është terapia kryesore për pacientët që janë mbipesh dhe obez. Edhe humbja e peshës në mënyrë të moderuar së bashku e kombinuar me rritjen e aktivitetit fizik mund të përmirësojë ndjeshmërinë ndaj insulinës dhe kontrollin e glicemisë në pacientët me diabet tip 2 dhe të parandalojë zhvillimin e diabetit tip 2 tek personat me rrezik të lartë (d.m.th., ata me tolerancë të dëmtuar të glukozës). Shoqata Amerikane e Diabetit, Shoqata e Amerikës së Veriut për Studimin e Obezitetit, dhe Shoqata Amerikane për Te Ushqyerit Klinik janë bashkuar së bashku për të nxjerrë këtë deklaratë mbi përdorimin e modifikimit të stilit të jetesës në parandalimin dhe menaxhimin e diabetit tip 2 [14].

Duke qenë se diabeti mellitus i tipit 2 është një sëmundje e zakonshme kronike që është përgjegjëse për kosto të mëdha njerëzore dhe financiare, modifikimi i stilit të jetës (d.m.th. humbja e peshës në mënyrë të moderuar dhe rritja e aktivitetit fizik) është qasja më efektive në mënyrë konsistente për parandalimin e diabetit. Po ashtu edhe medikamentet, përfshirë metforminën dhe tiazolidinedinën, përbëjnë një terapi efektive për parandalimin ose vonimin e diabetit. Ndërhyrjet janë parë të jenë efektive edhe përgjatë moshave të ndryshme edhe sipas përkatesisë etnike. Zbatimi i këtyre gjetjeve në nismat e shëndetit publik ka qenë i ngadalë, të paktën pjesërisht për shkak të implikimeve të tyre financiare [15].

5.3. CILËT JANË MË TE RISKUARIT PËR TË ZHVILLUAR DM 2?

Sipas shumë studimeve ka një grup të caktuar personash të cilët janë më të riskuar për shfaqjen e diabetit tipi 2.

∞ **Kështu duke filluar me duhanëpirësit.**

Një studim prospektiv në 7,735 burra të moshës 40-59 në 24 qytete britanike për një mesatare prej 16.8 vitesh u zhvillua nëpërmjet kontrolleve sistematike në kujdesin parësor dhe pyetësoreve. Gjithsej 290 raste të reja me diabet u gjetën në 7,124 burra pa histori diabeti, sëmundje koronare të zemrës ose goditje në tru. Pirja e duhanit u pa të shoqërohej me një rritje të konsiderueshme të rrezikut nga diabeti, madje edhe pas rregullimit për moshën, BMI dhe konfrontuesit e tjerë të mundshëm. Burrat që hoqën dorë nga pirja e duhanit gjatë 5 viteve të para të ndjekjes treguan rritje të konsiderueshme në peshë dhe më pas rrezik më të lartë të diabetit sesa duhanpirësit e vazhdueshëm. Pirja e duhanit është një faktor rreziku i pavarur dhe i modifikueshëm për diabetin tip 2. Ndërprerja e pirjes së duhanit shoqërohet me shtim në peshë dhe rritje të mëvonshme të rrezikut nga diabeti, por në një term afatëgjatë përfitimet e heqjes dorë nga pirja e duhanit tejkalojnë efektet e pafavorshme të shtimit të hershëm të peshës [16].

∞ **Personat që bëjnë jetë sedentare.**

Është vërtetuar që aktiviteti fizik luan një rol të rëndësishëm në uljen e obezitetit dhe pasojë diabetit. Megjithatë, disa studime kanë ekzaminuar lidhjen midis sjelljeve të ulura siç është shikimi i zgjatur i televizionit, mbipeshës dhe diabetit. Duke përdorur të dhëna nga një studim prospektiv kohort, profesionistët e shëndetit vërtetuan se rritja e shikimit në TV është e lidhur fort me shtimin në peshë, pavarësisht nga dieta dhe ushtrimet. Gjithashtu, shikimi i zgjatur i TV shoqërohet me një rrezik të rritur ndjeshëm të diabetit tip 2. Burrat që shikonin TV më shumë se 40 orë në javë kishin një rritje gati trefish më shumë në lidhje me rrezikun e shfaqjes së DM 2, krahasuar me ata që kaluan më pak se 1 orë në javë duke parë TV. Kështu, fushatat e shëndetit publik për të zvogëluar rrezikun e mbipeshës dhe diabetit tip 2 duhet të promovojnë jo vetëm rritjen e niveleve të stërvitjes, por edhe zvogëlimin e sjelljeve sedentare, veçanërisht shikimin e zgjatur të TV [17].

∞ **Personat që konsumojnë alkool.**

Provat në lidhje me lidhjen midis konsumit të alkoolit dhe rrezikut të diabetit tip 2 mbeten joekzistente, përsa u përket dallimeve mashkull-femër. Sipas një studimi prospektiv kerkohej të zbulohej lidhje midis pirjes së alkoolit dhe DM tipi 2, në një grup prej 12.261 pjesëmarrësish të moshës së mesme, të cilët u ndoqën 3-6 vjet. Rastet e reja me diabet u përcaktuan nga matjet e glukozës në gjak dhe vetë-raportimi. Pas rregullimit për konfrontuesit e mundshëm, një rrezik i rritur për diabeti u gjet te burrat që pinin > 21 pije / javë kur u krahasuan me burrat që pinin 1 pije / javë ndërsa jo lidhje domethënëse u gjet tek gratë. Ky rrezik i rritur në diabet midis burrave që pinin > 21 pije / javë ishte kryesisht i lidhur me pije të tjera alkoolike sesa me birra ose konsumim të verës. Rezultatet e këtij studimi mbështesin hipotezën se marrja e lartë e alkoolit rrit rrezikun e diabetit tek burrat e moshës mesatare. Sidoqoftë, nivelet më të moderuara të konsumimit të alkoolit nuk rrisin rrezikun për diabet të tipit 2 tek burrat e moshës mesatare ose te gratë [18].

∞ **Faktorë të tjerë**

Gjenetika gjithashtu do të luajë një rol të rëndësishëm në shfaqjen e diabetit tipi 2. Janë raportuar më shumë se 20 vendodhje gjenetike të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin e kësaj patologjie, shumica e varianteve të raportuara kanë efekte të vogla deri në të moderuar dhe përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të trashëgimisë së DM 2 duke sugjeruar që shumica e variacionit gjenetik ndër-person te kjo sëmundje mbetet për t'u përcaktuar [19]. Ndër faktorë të tjerë do të përmendim: adipoziteti, biomarkerët e serumit (rritja e nivelit të aminotransferazës alaninë, gamma-glutamyl transferaza, acidi urik dhe proteina reaktive C, dhe ulja e nivelit të adiponektinës dhe vitaminës D), një model diete jo i shëndetshëm (rritja e konsumit të mishit të përpunuar dhe sheqerit -pije e ëmbëlsuar, ulje e konsumit të drithërave, dhe mosrespektimi i një modeli diete të shëndetshme), niveli i ulët arsimor, ulja e aktivitetit fizik kohëzgjatja e shikimit në televizion, pirja e alkoolit, pirja e duhanit, ndotja e ajrit dhe disa kushte mjekësore (presioni i lartë sistolik i gjakut, ardhja e menseve me vonesë, diabeti gestacional, sindromi metabolik, lindja e parakohshme) paraqitën prova të forta për rritjen e rrezikut të DM 2 [20]. Shumë raste të DM 2 mund të parandalohen me ndryshime në stilin e jetës, duke përfshirë ruajtjen e një peshe konstante për trupin, konsumimin e një diete të shëndetshme, qëndrimin aktiv fizikisht, mos pirjen e duhanit dhe pirjen e alkoolit në doza të moderuara [21].

5.4 EPIDEMIOLOGJIA E DM TIPI 2.


Në nivel global, numri i personave me diabet mellitus është katërfishuar në tre dekadat e fundit, dhe diabeti mellitus është shkaku i nëntë kryesor i vdekjes. Rreth 1 në 11 të rritur në të gjithë botën tani kanë diabet mellitus, 90% prej të cilëve kanë diabet mellitus tip 2. Azia është një ndër zonat më të mëdha për zhvillimin e DM 2 e ndjekur nga Kina dhe India. [21] Më shumë se 34 milion amerikanë kanë diabet (1 nga 10) dhe 90-95% e tyre kanë diabetin tipi 2. DM 2 zhvillohet zakonisht rreth moshës 45 vjeç, por gjithashtu është parë të zhvillohet edhe në fëmijë dhe adoleshent. [22]

Me gjithë përdorimin e një game të gjerë të metodologjive të ndryshme dhe kriterëve diagnostikuese, studimet epidemiologjike kanë treguar që diabeti i tipit 2 (jo i pavarur) ka një shpërndarje globale dhe përhapja e tij ndryshon nga një vend në tjetrin, në grupe të ndryshme etnike në të njëjtin vend, dhe midis të njëjtit grup etnik me migrim të brendshëm ose të jashtëm. Studimet rurale-urbane dhe migracioni tregojnë se ndryshimi drejt një stili jetese 'të perëndimit' shoqërohet me një rritje dramatike të shkallës së prevalencës për diabetin tip 2. Nivele të ulëta të prevalencës për diabetin tip 2 janë parë në Eskimos dhe popullsitë e Lindjes së Largët, ndërsa më të lartat janë parë tek Indianët Amerikanë, popullsitë e urbanizuara të ishullit të Paqësorit dhe indianët migrantë aziatikë. Provat e disponueshme sugjerojnë që këto grupe kanë një ndjeshmëri gjenetike ndaj diabetit tip 2 dhe se sëmundja nuk është maskuar nga faktorët mjedisorë. Megjithatë duket se ekziston një spektër i ndërveprimit midis faktorëve gjenetikë dhe mjedisit, në disa popullsi roli gjenetik mund të jetë më i rëndësishëm se ai mjedisor, ose anasjelltas. Studimet epidemiologjike, përveç vlerës së tyre në depistimin e popullatës dhe gjetjen e rasteve, kanë kontribuar në klasifikimin e ri dhe kriteret diagnostikuese të diabetit dhe të kuptuarit tonë ndaj faktorëve të rrezikut dhe etiologjinë e diabetit tip 2. [23]

Përsa u përket vendeve Europiane, prevalenca e DM 2 është shumë e lartë, sidomos në Gjermani, ndërsa në Norvegji dhe Islandë prevalenca është e ulët. Parashikimet e epidemiologëve për të tretën e parë të shekullit 21 pretendojnë deri në 2.5 herë rritje të prevalencës së DM 2 në Lindjen e Mesme, Afrikën Sub-Sahariane, Indi, Azi dhe Amerikën Latine. Në Kinë numri i pacientëve me

DM 2 do të dyfishohet në vitin 2030. Në vendet e përparuara ekonomikisht rritja do të jetë rreth 50% në 2030. Rritja e urbanizimit, popullsia në plakje, mbipesha dhe niveli i rënies së aktivitetit fizik, të gjitha po kontribuojnë në ngritjen e DM 2 në të gjithë botën. Shkaku kryesor i pandemisë së DM 2 është përhapja në rritje e mbipeshes në Evropë dhe Sh.B.A. Në Amerikën e Veriut dhe vendet e Bashkimit Evropian mbipesha konsiderohet të jetë përgjegjëse për deri në 70-90% të DM 2 në popullatën e rritur. Mekanizmi i saktë me të cilin mbipesha çon në rezistencë ndaj insulinës dhe në DM 2 nuk është plotësisht i njohur por mund të ketë lidhje me disa faktorë biokimikë si anomalitë në acidet yndyrore të lira, adipokinat, leptinën dhe substancat e tjera [24]. Gjithashtu në një studim të bërë parashikohet që për vitet 2018-2028 do të rritet prevalenca e DM 2 ku vetëm në vitin 2018 janë 500 milion raste me DM 2. Kjo shfër do të vazhdojë të rritet përgjatë viteve, por prevalenca më e lartë do të jetë në vendet me zhvillim të ulët [25].

Grafiku 1.



5.5 KOMPLIKACIONET E DIABETIT MELITUS TIPI 2.

Nëse keni DM2 dhe nëse ju nuk punoni të mbani në nivelin e duhur glukozën, atëherë do të përballeni me komplikacione të sëmundjes [26].

Përsa u perket komplikacioneve, **muskuloskeletalet** janë ndër më të shpeshtat. Në një studim të bërë u vrojtuan komplikacionet më të shpeshta të duarëve dhe shpatullave te pacientët me DM2. Prania e “Cheiroarthropathy”, shpatulla e ngrirë, kontraktimi i “Dupuytren” dhe gishtit i këmbës u vlerësuan në 102 pacientë me diabet të tipit 2 dhe 101 kontrole jo-diabetike, të kombinuar sipas moshës dhe seksit. Gjithashtu është analizuar marrëdhënia midis këtyre komplikimeve dhe moshës, seksit, kohëzgjatjes së diabetit dhe kontrollit të glicemisë. “Cheiroarthropathy”, shpatulla e ngrirë dhe kontraktimi i “Dupuytren” ishin dukshëm më të përhapura në grupin diabetik sesa në grupin e kontrollit. Femrat ishin prekur më pak nga shpatullat e ngrira sesa meshkujt dhe rastet e avancuara (faza 2) e “Cheiroarthropathy” ishte më e shprehur te femrat. Kohëzgjatja e diabetit ishte e lidhur me një rrezik të shtuar të ëmundjeve muskuloskeletale. Si përfundim, disa çrregullime muskulore janë më të përhapura tek pacientët me diabet mellitus tip 2 dhe kjo mund të shoqërohet me kontrollin e glicemisë, seksin dhe kohëzgjatjen e diabetit [27].

Sëmundjet kardio-cerebrovaskulare shoqërohen shpesh me diabetin e tipit 2 dhe mund të bëhen kërcënuese për jetën, veçanërisht koronaropatia, goditja në tru dhe dështimi i zemrës. Klinikisht ndonjëherë mund të shfaqen atipike dhe të heshtura për një kohë të gjatë [28].

Sipas një studimi të kryer është vlerësuar **neuropatia** ne pacientët me DM2. E cila mund të preki 50% te personave të prekur me DM 2. Neuropatia diabetike mund të kategorizohet si më poshtë: Neuropatia ndijore ndodh kur nervat që zbulojnë prekjën dhe temperaturën dëmtohen. Kjo formë e neuropatisë zakonisht prek këmbët dhe duart. Neuropatia motorike rezulton nga dëmtimi i nervave që ndikojnë në lëvizjen e muskujeve dhe neuropatia autonome prek nervat që kontrollojnë veprimet e pavullnetshme, të tilla si tretja ose rrahjet e zemrës preken.[29]

Në një studim të kryer u vlerësua neuropatia në crregullimet orale. Sëmundjet e mukozës, humbja e dhëmbit dhe mosfunksionimi temporomandibular u ekzaminuan në 45 pacientë me diabet mellitus afatgjatë të tipit 2 dhe në 77 subjekte kontrolli. Shfaqja e neuropatisë u vlerësua me teste neurofizilogjike. Nga pacientët me diabet, 56% vuanin nga tharja e gojës dhe 18% nga glosodinia; te grupi i kontroleve, përkatësisht, 36% dhe 7%.. Mosfunksionimi i përbashkët i temporomandibular u gjet në 27% të subjekteve me diabet dhe në 16% të subjekteve të kontrollit. Neuropatia periferike ishte e pranishme në 42% të pacientëve me diabet dhe në asnjë nga kontrollet dhe neuropatia autonome parasimpatike në 54% dhe 31%. Kështu neuropatia diabetike u konstatua se shoqërohet me humbjen e dhëmbit dhe mosfunksionimin e përbashkët temporomandibular[29].

Retinopatia është gjithashtu një ndër komplikacionet më të zakonshme të DM2 dhe është shkaku më i shpeshtë i rasteve të reja të verbërisë tek të rriturit e moshës 20-74 vjeç. Gjatë dy dekadave të para të sëmundjes, pothuajse të gjithë pacientët me diabet tip 2 kanë retinopati. Në Studimin Epidemiologjik të EËsconsin të Retinopatisë Diabetike (EËSDR) 1.6% e pacientëve me moshë të vjetër ishin të verbër. Në grupin e të rinjve, 86% e verbërisë i atribuohet retinopatisë diabetike. Në grupin e të moshuarve, në të cilin sëmundjet e tjera të syve ishin të zakonshme, një e treta e rasteve të verbërisë ishin për shkak të retinopatisë diabetike [30].

Sëmundjet renale. DM 2 është i lidhur me rritjen e vdekshmërisë kur shoqërohet me komplikacione si sëmundjet e veshkave. Sipas një studimi është analizuar vdekshmëria kumulative 10-vjeçare nga diabeti dhe gjendja e sëmundjes së veshkave për 15,046 pjesëmarrës në Sondazhin e Tretë Kombëtar të Shëndetit dhe Ekzaminimit të Ushqimit (NHANES III) duke lidhur të dhënat bazë nga NHANES III me Indeks Kombëtar të Vdekjes. Sëmundja e veshkave, e përkufizuar si raport albuminë / kreatininë urinare ≥ 30 mg / g, ishte e pranishme në 9.4% dhe 42.3% të individëve përkatësisht pa dhe me diabet tip 2. Midis njerëzve pa diabet dhe me sëmundje të veshkave (grupi i referencës), vdekshmëria kumulative 10-vjeçare nga të gjitha shkaqet ishte 7.7% i standardizuar sipas moshës së popullsisë, seksit dhe racës . Midis individëve me diabet por pa sëmundje të veshkave, vdekshmëria e standardizuar ishte 11.5% që përfaqëson një ndryshim absolut të rrezikut me grupin e referencës prej 3.8%, përshtatur sipas demografisë. Midis individëve me diabet dhe sëmundje të veshkave, vdekshmëria e standardizuar ishte 31.1% që përfaqëson një ndryshim absolut të rrezikut me grupin referues prej 23.4%, përshtatur sipas demografisë. Po ashtu janë vërejtur modele të ngjashme për vdekshmërinë kardiovaskulare dhe jo kardiovaskulare. Si përfundim ata me sëmundje të veshkave kanë patur një vdekshmëri më të lartë të pacienetë diabetik krahasim me grupet e tjera. [31]

Apneja gjatë gjumit. Nje studim i bërë synonte të vlerësonte prevalencën dhe karakteristikat e sindromës së apnesë së gjumit (SAS) në pacientët e shtruar në spital për diabet të tipit 2. Ishte një studim i cili u krye brenda natës në 303 pacient radhazi. [32]

Rezultatet e studimit treguan se 34% e këtyre pacientëve kishin SAS të lehtë, siç përcaktohet nga një indeks i shqetësimit të frymëmarrjes (RDI) prej 5-15; 19% kishin SAS të moderuar (RDI: 16–29) dhe 10% kishin SAS të rëndë (RDI ≥ 30). SAS ishte obstruktive në 99% të pacientëve apneikë. Përqindja e pacientëve me përgjumje të lartë gjatë ditës (shkalla e përgjumjes Epëorth > 10), lodhje ose nokturi nuk ndryshonte dukshëm midis pacientëve me SAS të rëndë, të moderuar ose të lehtë kundrejt pacientëve jo apneikë. Përqindja e pacientëve që gërhinin ishte dukshëm më e lartë në pacientët me SAS të rëndë ose të moderuar kundrejt pacientëve jo apneikë. HbA1c, kohëzgjatja e diabetit dhe mbizotërimi i mikroalbuminurisë, retinopatisë dhe neuropatisë periferike nuk ndryshuan dukshëm midis pacientëve me SAS të rëndë, të moderuar ose të lehtë kundrejt pacientëve jo apneikë. Sidoqoftë, pacientët me SAS të rëndë ose të moderuar kishin vlera dukshëm më të larta për indeksin e masës trupore, perimetrin e belit dhe perimetrin e qafës sesa pacientët jo apneikë. Si përfundim në pacientët diabetikë të tipit 2, SAS obstruktiv është shumë i përhapur dhe lidhet me perimetrin abdominal, dhe duhet të kontrollohet sistematikisht, pasi nuk mund të parashikohet nga të dhënat klinike. [32].

Gjithashtu një studim tjetër përcaktoi një prevalencë të lartë të (SAS)në të rriturit me diabet mellitus tipi 2. Kështu ky studim regjistroi 330 të rritur radhazi me DM 2 të referuar në një klinikë diabeti, 279 prej të cilëve përfunduan studimin. Vlerësimi i pranisë së SAS u krye me përdorimin e një pajisje regjistrimi me një kanal që mat ngjarjet e çrregullta të frymëmarrjes nga një sinjal i rrjedhës së ajrit prej hundës. Pajisja është përdorur nga pjesëmarrësit e studimit në shtëpinë e tyre, pas udhëzimeve në përdorimin e duhur nga stafi klinik në qendrën e diabetit. Prania dhe ashpërsia e SAS u përcaktuan me përdorimin e një indeksi apne-hipopne (AHI), duke pasqyruar periudhat e frymëmarrjes së zvogëluar dhe të munguar. Të dhënat e informacionit demografik dhe mjekësor u mbledhën për të zbuluar faktorët e lidhur me SAS në këtë popullatë të studimit. Për

më tepër, u krye një analizë e kohës dhe kostos në lidhje me procesin e shqyrtimit për SAS nga stafi klinik në qendrën e diabetit. Rezultatet treguan një prevalencë të lartë të SAS në të rriturit me DM 2, duke filluar nga 48%. Variablat e mëposhtëm u shoqëruan me SAS: mosha ≥ 62 vjeç, seksi mashkull, indeksi i masës trupore ≥ 30 kg / m², gërhitja dhe raportet e ndalimit të frymëmarrjes gjatë gjumit. Si përfundim ky studim tregoi që SAS ka një prevalencë të lartë tek të rriturit me DM 2. Vlerësimi për SAS mund të kryhet lehtësisht në një ambient ambulator me një pajisje regjistruese portative siç është ajo e përdorur në këtë studim. Kontrolli për SAS duhet të konsiderohet në popullatën DM 2.[33]

Koma diabetike është një komplikacion i cili mund të vij kur glicemia në gjak rritet më shumë se 600(mg/dl), simptoma e saj e parë është dehidrimi. Zakonisht prek njerëzit me diabet tip 2 që nuk kanë kontroll të mirë të glicemisë. Është më shumë e pranishme te të sëmurët kronikë, të moshuarit apo te personat me aftësi të kufizuara. Mjekët nuk janë të sigurt pse, por ata mendojnë se këta njerëz mund të mos e kuptojnë se janë të etur ose mund të mos jenë në gjendje të pijnë mjaftueshëm..Kjo është një gjendje e rëndë, dhe nëse nuk dallohet shpejt dhe nuk trajtohet shpejt, mund të jetë fatale.Njohja e simptomave është e rëndësishme. [34]

- ∞ Temperaturë e lartë
- ∞ Dobësi
- ∞ Përgjumje
- ∞ Gjendje e alteruar mendore
- ∞ Dhimbje koke
- ∞ Pamundësia për të folur
- ∞ Probleme vizuale
- ∞ Halucinacione
- ∞ Paraliza
- ∞ Etje
- ∞ Urinim i shpeshtë. [34]

Stroku. Në një goditje, një nga enët e shumta të gjakut që furnizojnë trurin me oksigjen dëmtohet ose bllokohet. Nëse rrjedha e gjakut ndërpritet për më shumë se 3 deri në 4 minuta, ajo pjesë e trurit fillon të vdesë. Diabeti mund ta bëjë më të vështirë për trupin për t'iu përgjigjur një goditje në tru. Kur furnizimi me oksigjen ndërpritet, arteriet e tjera zakonisht mund të shërbejnë si bajpas. Por nëse keni diabet, ato enë mund të ngurtësohen ose të bllokohen me pllaka, një gjendje e njohur si ateroskleroza. Kjo e bën më të vështirë për gjakun të shkojë në tru.[35]

Dëmtimet e leëkurës. Janë të pranishme ne DM 2. Diabeti afatgjatë i tipit 2 me hiperglicemi, ka tendencë të shoqërohet me qarkullim të dobët, i cili zvogëlon rrjedhjen e gjakut në lëkurë. Gjithashtu mund të shkaktojë dëmtime të enëve të gjakut dhe nervave. Aftësia e qelizave të bardha të gjakut për të luftuar infeksionet është gjithashtu e zvogëluar për shkak të ngritjes së sheqerit në gjak.Ulja e qarkullimit të gjakut mund të çojë në ndryshime në kolagjenin e lëkurës. Kjo ndryshon strukturën, pamjen dhe aftësinë e shërimit të lëkurës. Dëmtimi i qelizave të lëkurës madje mund të ndërhyjë në aftësinë për të djersitur. Gjithashtu mund të rrisë ndjeshmërinë ndaj temperaturës dhe presionit. Neuropatia diabetike mund të shkaktojë ndjesi të zvogëluar. Kjo e bën lëkurën më të prirur ndaj plagëve. [36]

Midis 51.1% dhe 97% e njerëzve me diabet do të përjetojnë një gjendje të lidhur me lëkurën, sipas një përmbledhje të kohëve të fundit të literaturës. Për këtë arsye, njerëzit me diabet të tipit 2 duhet të kujdesen për:

- ∞ ndryshimet në lëkurën e tyre
- ∞ lëndime ose acarim të lëkurës që rrethon vendet e injektimit të insulinës
- ∞ prerje ose plagë që shërohen ngadalë, pasi plagët me shërim të ngadaltë shpesh janë hyrje të infeksioneve dytësore
- ∞ prerje ose plagë që duken të infektuara. [36].

Gjithashtu duhet patur parasysh se dëmtimet e lëkurës të shkaktuara nga diabeti zakonisht përfshijnë infeksion bakterial ose fungual.

Infeksionet bakteriale. Infeksionet bakteriale janë të zakonshme për të gjithë. Sidoqoftë, këto lloj infeksionesh janë veçanërisht problematike për njerëzit me diabet të tipit 2. Këto gjendje të lëkurës shpesh janë të dhimbshme dhe të ngrohta në prekje, me ënjtje dhe skuqje. Ato mund të rriten në madhësi, numër dhe frekuencë nëse niveli i glukozës në gjak është i rritur kronikisht. Bakteret më të zakonshme që shkaktojnë infeksione të lëkurës janë Staphylococcus dhe Streptococcus. Infeksionet serioze bakteriale mund të shkaktojnë dëmtime të thella të nënlëkurës të quajtura karbunkula. Këto mund të kenë nevojë të çahen nga një mjek dhe të drenohen. Nëse dyshoni se keni një infeksion bakterial, njoftoni menjëherë mjekun tuaj që të mund të mjekoheni me antibiotikë. [36].

- ∞ Infeksione të tjera të zakonshme bakteriale përfshijnë:
- ∞ Vlon (boils)
- ∞ Stilet, ose infeksionet rreth folikulit, ose infeksione të gjëndrave të flokëve
- ∞ Infeksione rreth thonjve

Infeksionet mykotike. Të shkaktuara nga përhapja e kërpudhave ose majave, janë gjithashtu të zakonshme për të gjithë njerëzit me diabet. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse glukozja në gjak nuk është e kontrolluar mirë. Infeksionet e majave duken si zona me lëkurë të kuqe, shkaktojnë prurit, janë të fryra dhe të rrethuara me fluska ose të thata.[36]

Kërpudhat e majave prekin zonat e mëposhtme:

- ∞ në palosjet e ngrohta të lëkurës
- ∞ nën gjinj
- ∞ në ijë
- ∞ në sqetulla
- ∞ në cepat e gojës. [36]

Disa komplikacione të tjera të diabetit tipi 2 janë:

- ∞ Presioni i lartë i gjakut. Shumë njerëz me diabet tip 2 kanë probleme me presionin e lartë të gjakut. Nëse kjo nuk trajtohet, rreziku i sulmit në zemër, goditjes në tru, problemeve me shikimin dhe sëmundjeve të veshkave mund të rritet. Duhet monitoruar presioni i gjakut

rregullisht. Një dietë me pak natrium, ushtrime të rregullta dhe zvogëlimi i stresit mund të mbajnë nën kontroll presionin e gjakut. Mjeku gjithashtu mund të përshkruajë ilaçe për të trajtuar hipertensionin.

- ∞ Depresioni. Ndërsa shkencëtarët nuk e kuptojnë plotësisht lidhjen midis diabetit dhe depresionit, ata e dinë që njerëzit me diabet janë në një rrezik më të lartë të përjetojnë depresion. Diabeti mund të jetë stresues dhe emocionalisht rraskapitës.
- ∞ Gastropareza. Nëse nivelet e sheqerit në gjak mbeten të larta për një periudhë të gjatë kohore, mund të ndodhë dëmtim i nervit vagus. Nervi vagus është nervi që kontrollon lëvizjen e ushqimit përmes aparatit tretës. Gastropareza lind kur nervi vagus dëmtohet ose ndalet së funksionuari. Kur kjo të ndodhë, stomakut i duhet më shumë kohë se normalisht për të zbratur përmbajtjen e tij. Kjo quhet zbrazja e vonuar e stomakut. Simptomat e gastroparezës përfshijnë: të përziera dhe të vjella, urth, ndjenja e ngopjes, humbje e oreksit, humbje peshe dhe spazma e stomakut. Gastropareza gjithashtu mund ta bëjë më të vështirë menaxhimin e niveleve të glukozës. Mënyra më e mirë për të parandaluar gastroparezën është të menaxhoni nivelet e sheqerit në gjak me kalimin e kohës.
- ∞ Demenca. Shkencëtarët kohët e fundit kanë krijuar një lidhje midis diabetit të tipit 2 dhe sëmundjes Alzheimer, lloji më i zakonshëm i demencës. Shumë sheqer në gjak mund të dëmtojë trurin me kalimin e kohës, prandaj është e rëndësishme të mbani nën kontroll nivelet e sheqerit në gjak. [37]

5.6 TRAJTIMI I DM 2.

Për të arritur një kontroll të mirë metabolik afatgjatë të të sëmurët diabetik është i rëndësishëm një kombinim i ndryshimeve të stilit të jetës dhe trajtimit farmakologjik. Arritja e hemoglobinës së glukozuar gati-normale në mënyrë të konsiderueshme, zvogëlon rrezikun e komplikimeve makrovaskulare dhe mikrovaskulare. Aktualisht ekzistojnë trajtime të ndryshme, si nga goja ashtu edhe SC (subcutane), të disponueshëm për trajtimin e diabetit të tipit 2. Algoritmet e trajtimit të dizajnuara për të zvogëluar zhvillimin ose përparimin e ndërlikimeve të diabetit theksojnë nevojën për një kontroll të mirë të glicemisë. Ndërhyrja fillestare duhet të përqendrohet në ndryshimet e stilit të jetës. Për më tepër, ndryshimet në stilin e jetës kanë provuar se janë të dobishme, nëse aplikohen gjithmone. [38]

Mjekët duhet të jenë të njohur me llojet e ndryshme të barnave ekzistuese për trajtimin e diabetit dhe të zgjedhin ato më efektive, të sigurta dhe ato që pacienti toleron më mirë. Metformina mbetet zgjedhja e parë e trajtimit për shumicën e pacientëve. Opsione të tjera alternative ose të trajtimit të linjës së dytë duhet të individualizohen në varësi të karakteristikave të secilit pacient. [38]

Terapia farmakologjike është shpesh e nevojshme për të arritur kontrollin optimal të glicemisë në menaxhimin e diabetit. Agjentët OHA (antihyperglicemikë të administruar nga goja) mund të përdoren vetëm ose në kombinim me OHA të tjera ose me insulinë. Numri i OHA-ve në dispozicion është rritur ndjeshëm në dekadën e fundit. [39]

Disa nga medikamentet më të përdorura janë:

- ∞ Metformin, Glukofag, Glumetza, etj. Në përgjithësi, siç u përmend edhe më lart, metformina është ilaçi i parë i përshkruar për diabetin e tipit 2. Funksionon duke ulur prodhimin e glukozës në mëlçi dhe duke përmirësuar ndjeshmërinë e trupit tuaj ndaj insulinës në mënyrë që trupi juaj të përdorë insulinën në mënyrë më efektive. Nauze dhe diarreja janë efekte anësore të metforminës. Këto efekte anësore mund të zhduken ndërsa trupi juaj mësohet me ilaçin ose nëse e merrni medikamentin në një orar të caktuar.
- ∞ Sulfonilureat. Këto ilaçe ndihmojnë trupin tuaj të sekretojë më shumë insulinë. Shembujt përfshijnë glyburide (DiaBeta, Glynase), glipizide (Glucotrol) dhe glimepiride (Amaryl). Efektet e mundshme anësore përfshijnë sheqer të ulët në gjak dhe shtim në peshë.
- ∞ Meglitinidet. Këto ilaçe të tilla si repaglinid (Prandin) dhe nateglinide (Starlix) funksionojnë si sulfonilurea duke stimuluar pankreasin që të sekretojë më shumë insulinë, por ato veprojnë më shpejt dhe kohëzgjatja e efektit të tyre në trup është më e shkurtër. Ata gjithashtu kanë një rrezik për të shkaktuar hipoglicemi dhe shtim në peshë.
- ∞ Tiazolidinediones. Ashtu si metformina, këto ilaçe përfshijnë rosiglitazonin (Avandia) dhe pioglitazonin (Actos) të cilat i bëjnë indet e trupit më të ndjeshme ndaj insulinës. Këto barna janë lidhur me shtimin e peshës dhe efekte të tjera anësore më serioze, të tilla si; një rrezik në rritje të dështimit të zemrës dhe anemisë. Për shkak të këtyre rreziqeve, këto ilaçe zakonisht nuk janë trajtime të zgjedhjes së parë.
- ∞ Frenuesit e DPP-4. Këto ilaçe si; sitagliptin (Januvia), saxagliptin (Onglyza) dhe linagliptin (Tradjenta), ndihmojnë në uljen e niveleve të sheqerit në gjak, por prirjen të kenë një efekt të moderuar. Ato nuk shkaktojnë shtim në peshë, por mund të shkaktojnë dhimbje të kyçeve dhe të rrisin rrezikun e pankreatitit.
- ∞ Frenuesit e SGLT2. Këto ilaçe parandalojnë që veshkat të rithithin glukozën në gjak. Në vend të kësaj, glukozja ekskretohet në urinë. Shembujt përfshijnë canagliflozin (Invokana), dapagliflozin (Farxiga) dhe empagliflozin (Jardiance). Medikamentet në këtë klasë të ilaçeve mund të zvogëlojnë rrezikun e sulmit në zemër dhe goditjes në njerëz tek njerëzit me një rrezik të lartë të atyre kushteve. Efektet anësore mund të përfshijnë infeksione të majave vaginale, infeksione të traktit urinar, presion të ulët të gjakut dhe një rrezik më të lartë të ketoacidozës diabetike. Canagliflozin, por jo ilaçet e tjerë në këtë klasë, është e shoqëruar me rritjen e rrezikut të amputimit të gjymtyrëve të poshtme.
- ∞ Agonistët e receptorëve GLP-1. Këto ilaçe me injeksion ngadalësojnë tretjen dhe ndihmojnë në uljen e niveleve të glukozës në gjak. Përdorimi i tyre shpesh shoqërohet me humbje peshe. Efektet e mundshme anësore përfshijnë nauze dhe një rrezik në rritje të pankreatitit. Exenatide (Byetta, Bydureon), liraglutide (Victoza) dhe semaglutide (Ozempic) janë shembuj të agonistëve të receptorëve GLP-1. Hulumtimet e fundit kanë treguar se liraglutide dhe semaglutide mund të zvogëlojnë rrezikun e sulmit në zemër dhe strotkut në njerëz në njerëz me rrezik të lartë për këto sëmundje. [40]

Insulina

Njerëzit me diabet të tipit 2 mund të kërkojnë insulinë kur plani i ngrënies, humbja e peshës, stërvitja dhe ilaçet antidiabetike nuk arrijnë nivelet e synuara të glukozës në gjak. Diabeti është një sëmundje progresive dhe trupi mund të kërkojë injeksione të insulinës për të kompensuar

prodhimin e ulët të insulinës nga pankreasi. Trajtimi me insulinë mund ti bashkangjitet një medikamenti oral ose ta zëvendësojë atë plotësisht. Pavarësisht nga trajtimi, zakonet e jetesës (dieta, ushtrimet, menaxhimi i stresit) janë thelbësore për menaxhimin e diabetit. Kjo është arsyeja pse fillimi i trajtimit me insulinë nuk duhet parë kurrë si dështim. [41] Me përjashtim të insulinës, të gjithë ilaçet për diabetin kanë aftësi të kufizuar për uljen e glukozës. Prandaj, ndërsa përparon diabeti i tipit 2, insulina shpesh është e nevojshme për të arritur synime glicemike gati-normale dhe për të shmangur ndërlikimet. [42]

Që terapia me insulinë ose ndonjë trajtim me tjetër medikament të jetë i suksesshëm, është e rëndësishme që mjeku jo vetëm të vendosë qëllime glicemike, por t'i komunikojë pacientit këto qëllime. Matja e HbA1c ndihmon në arritjen e një qëllimi afatgjatë, por edhe pacientët duhet ti përshtaten qëllimeve të vendosura nga mjeku, ose të jenë të vetëdijshëm se çfarë duhet të bëjnë nëse nuk përmbushin dot objektivat. Kuptimi i pacientëve për aftësitë e vetë-menaxhimit dhe fuqizimin e tyre është themelor për terapinë me insulinë.[43] Terapia me insulinë ofron efektin më të fuqishëm antihyperglicemik nga të gjithë agjentët e diabetit dhe ka një aftësi unike për të normalizuar gliceminë në pacientët e sapo diagnostikuar. [44].

Disa prej llojeve të insulinave të përdorura për trajtimin e DM 2 janë:

- ∞ Me veprim të shpejtë(Humalog, Novolog, Apidra). Keto lloje insulinash veprojnë brenda 15 minutash ose më pak, të cilat merret para vaktit. Te dikush pa diabet tip 2, trupi çliron sasinë e duhur të insulinës kur ha, është insulina që duhet t'i ndihmojë ata të përpunojnë dhe përdorin karbohidratet në ushqim. Ai çlirim i insulinës në kohën e ngrënies quhet sekretim i bolusit. Insulina me veprim të shpejtë imiton sekretimin e bolusit.
- ∞ Me veprim të rregullt ose me veprim të shkurtër(Velosulin). Insulina e rregullt (e quajtur edhe me veprim të shkurtër) vepron brenda brenda 30 minutash. Merret para ngrënies, por efekti i saj zgjat më shumë se insulina me veprim të shpejtë. Insulina e rregullt ose me veprim të shkurtër gjithashtu imiton sekretimin e bolusit.
- ∞ Me veprim të ndërmjetëm(NPH). Kjo lloj insuline zgjat për 10-16 orë. Në përgjithësi merret dy herë në ditë dhe përdoret për të imituar sekretimin bazal. Sekreti bazë është sasia e vogël e insulinës që duhet gjithmonë në gjak.
- ∞ Me veprim të gjatë(Glargine, Detemir): Ngjason me insulinën me veprim të ndërmjetëm, insulina me veprim të gjatë ndihmon sekretimin bazal. Insulina me veprim të gjatë zgjat për 20-24 orë, prandaj duhet ta merrni vetëm një herë në ditë ose të kombinuar me insulinë me veprim të ndërmjetëm dy herë në ditë.
- ∞ Para-miks(Humulin, Novoline, Humolog): Një insulinë e para-miks kombinon dy lloje të tjera të insulinës, p.sh një insulinë me veprim të shpejtë dhe një me veprim të ndërmjetëm. [45]

Dieta

Zhvillimet aktuale në trajtimin e diabetit të tipit 2 përqendrohet në arritjen e normoglicemisë përmes dietës, aktivitetit fizik dhe terapisë së medikamenteve. Dietologët klinikë janë partnerë qendrorë në menaxhimin e diabetit të tipit 2 dhe terapia e të ushqyerit konsiderohet ende terapia e

linjës së parë të zgjedhur. Roli i një nutricionisti në trajtimin e diabetit të tipit 2 është të sigurojë një dietë të përshtatshme ushqimore për pacientët, e pakomplikuara nga episodet e hipoglicemisë. Në këtë rol, nutricionistët klinikë duhet të jenë të vetëdijshëm për ndërveprimet e mundshme të ilaçeve me terapinë dietike.[46] Dieta është njohur gjithmonë si gur themeli në menaxhimin e diabetit, rekomandimet dietike evoluojnë vazhdimisht. Tani ekziston një farë konsensusi se qëllimet e terapisë mjekësore ushqimore duhet të jenë arritja dhe / ose ruajtja e një peshe të arsyeshme trupore, për të siguruar kontrollin më të mirë të mundshëm të glicemisë dhe për të zvogëluar faktorët e rrezikut kardiovaskular. [47]

